



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.07.2023

Nr: 693

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË “PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË”, QARKU
DURRËS, Z. ARKEND BASHKIM BALLA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 2181/3 prot., datë 11.07.2023, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati i deputetit të z. Rahman Rexhep Rraja, i zgjedhur në zonën zgjedhore, Qarku Durrës, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Partia Socialiste e Shqipërisë, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 69, datë 15.02.2021.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 21, datë 13.07.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të zhvilluara në datë 25.04.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr. 408 datë 23.06.2021 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese në zonën zgjedhore, Qarku Durrës, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.04.2021.

Data: 12.07.2023 Nr: 693
Ora: 12:00



“Për dhënie të mandatis të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, Qarku Durrës, z. Arkend Bashkim Balla”

Sipas këtij vendimi Partia Socialiste e Shqipërisë, për zonën zgjedhore, Qarku Durrës, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, ka fituar 8 (tetë) mandate.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, Qarku Durrës, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164 pika 2, të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit nr. 408, datë 23.06.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është miratuar rirënditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi, rezulton se, kandidatit të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 10 (dhjetë), z. Arkend Bashkim Balla.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, z. Arkend Bashkim Balla, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me 20 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile si dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për z. Arkend Bashkim Balla, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, Qarku Durrës, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Arkend Bashkim Balla.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, Qarku Durrës, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Arkend Bashkim Balla, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, Qarku Durrës, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Arkend Bashkim Balla, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Rahman Rexhep Rraja, i përket kandidatit vijues në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore Durrës, i renditur me numër rendor 10 (dhjetë), z. Arkend Bashkim Balla.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në Kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, Qarku Durrës, z. Arkend Bashkim Balla.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI